



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 33

Ndërtesa e Kuvendit, salla S - 1

Prishtinë, më 22.06.2016, në orën 10:00

**P R O C E S V E R B A L**

**Në mbledhje morën pjesë:** Flora Brovina, Hatim Baxhaku, Fadil Beka, Adem Hoxha dhe Besa Baftiu.

**Munguan:** Fikrim Damka, Mirjeta Kalludra, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Lunora Ahmeti - MPMS, Ukë Gashi – ZPRK, Fjolla Uka – KDI.

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

**Mbledhjen e kryesoi,** Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**REND I DITËS:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 06.06.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.*

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 06.06.2016

**Kryetarja** konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 06.06.2016, pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara**

**Flora Brovina**, kryetare e Komisionit, tha se ne kemi në shqyrtim edhe një herë raportin me rekomandime për Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, pasi e tërhoqëm nga seanca me propozimin e deputetes Besa Baftiu. Ne u pajtuam që ka ndodhur një lëshim të amendamenti numër 5, që nuk është dashur që në nenin 18 të ligjit bazik, të fshihet paragrafi 2, të cilin e ka fshirë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me Projektligjin e propozuar. Në ligjin në fuqi thuhet, „Për personin me aftësi të kufizuar njëqind 100% shfrytëzues i pensionit të aftësisë së kufizuar, pensioni të shndërrohet në asistencë personale për ndihmësin në punë (asistentin e tij)” ndërsa ne me amendament kemi thënë „Në nenin 18 të ligjit bazik, në fund të paragrafit 1, fjalia „ligjeve tatimore dhe doganore në fuqi” zëvendësohet me „një akti nënligjor të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës”, dhe paragrafi 2 fshihet nga teksti i ligjit” pra, ne kemi ndryshuar vetëm paragrafin 1. Mendojmë që është jo humane të fshihet paragrafi 2 nga ligji bazik. Prandaj këtë lëshim që ne nuk e kemi përmirësuar gjatë amendamentimit do ta përmirësojmë tani dhe nuk do të lejojmë që kjo e drejtë të realizohet sepse është një e drejtë shumë humane.

**Hatim Baxhaku** tha se ne nuk jemi kundër kësaj pike dhe mendojmë që këta persona duhet ta gëzojnë të drejtën të kenë asistent në rast nevojë, por ky ligj nuk e rregullon këtë të drejtë dhe nuk rregullon çështjen e pensioneve, por rregullon çështjen e aftësimit për punë për personat me aftësi të kufizuara. Pensionet dhe beneficionet duhet të rregullohen me ligje për pensionet e kësaj kategorie.

**Flora Brovina** kjo duhet të rregullohet me ligj të veçantë por duhet të mbetet edhe në këtë ligj, për arsye humane duhet të jetë në të dy ligjet edhe në ligjin për pensionet e personave me aftësi të kufizuara, por edhe në këtë ligj duhet të jetë e paraparë ndihma e asistentit për personin me aftësi të kufizuara.

**Besa Baftiu**, e di se ishte pak vonë vërejtja ime që e bëra, por nga analiza ime ishte shumë diskutabile fshirja e këtij neni. Kam shikuar edhe mos kjo çështje është e rregulluar me ndonjë ligj tjetër, por kjo nuk është e rregulluar. Mendoj se këta persona nëse aftësohen dhe punësohen patjetër duhet ta kenë asistentin që do t’ju ndihmojë. Pra, nëse duam t’i socializojmë këta persona atëherë duhet që vërtet t’ju ndihmojmë që të socializohen, të punojnë dhe të kenë asistent ata persona që janë 100% të pa aftë. Gjithashtu mendoj që t’i bëjmë edhe disa ndryshime në projektligj, në vend të shprehjes „kategori” të përdoret shprehja „llojet”. Gjithashtu neni që thotë se nëse ndërmarrjet nuk punësojnë persona me aftësi të kufizuar duhet ta paguajnë një pagë minimale. Unë mendoj se duhet të jetë „një pagë mesatare”.

**Flora Brovina** tha se më humane është kategoria sesa lloji, lloji tingëllon shumë keq.

**Besa Baftiu** tha se unë prapë mendoj se nuk duhet të jetë kategori sepse nuk duhet të ketë kategori të parë, kategori të dytë, por vetëm lloje.

**Flora Brovina** shtoi nëse pajtoheni do të votojmë vetëm për çështjen e asistentit për të cilën ne e tërhoqëm Projektligjin nga seanca.

**Besa Baftiu** kërkoi nga përfaqësuesja e Ministrisë ta sqarojë a është e rregulluar çështja e asistentit me ndonjë ligj të veçantë?

**Leunora Ahmeti** tha se si ministri kemi propozuar të fshihet ky paragraf se është i paqartë, ka zbrazëti dhe nuk është zbatuar asnjëherë. Gjithashtu Qeveria në këtë formë si është nuk mund ta zbatoj sepse nuk ka fonde për t'u siguruar asistent të gjithë shfrytëzuesve të kësaj skeme e që janë rreth 18 mijë shfrytëzues. Ne mendojmë ta rregullojmë me ligj të veçantë dhe ta precizojmë dhe ta përcaktojmë se cilët persona të aftësisë së kufizuar varësisht nga sëmundja të kenë edhe asistentin.

**Flora Brovina** pyeti si do të marrin pjesë në trajnim personat me paaftësi 100 %, nëse nuk kanë asistent t'i ndihmojë gjatë aftësimit?

**Hatim Baxhaku** tha se çështja e asistentit gjatë aftësimit për punë është e rregulluar me një amendament tjetër.

**Flora Brovina** mendon se personi me aftësi të kufizuara 100 % duhet ta ketë asistentin tërë kohën.

**Besa Baftiu** tha se pasi edhe përfaqësuesja e ministrisë është e mendimit se çështja e asistentit nuk është e rregulluar me ndonjë ligj tjetër, atëherë kjo çështje të mbetet në këtë ligj.

**Flora Brovina** mendon se ky nen nuk shkakton implikime buxhetore për Qeverinë sepse numri i personave 100 % të paaftë për punë, që aftësohen për punë dhe kanë nevojë për asistent është shumë i vogël.

**Hatim Baxhaku** mendon se ky nen nuk e ka pasur vendin në këtë ligj, por në Ligjin për pensionet për personat me aftësi të kufizuara. Ndërsa në aspektin mjekësor personi me paaftësi 100 % për punë nuk mund të aftësohet, ndërsa personi me 100 % paaftësi për një sëmundje të caktuar, ai mund të aftësohet për punë. Pra, duhet të dallohet paaftësia 100 % për punë, dhe paaftësi 100 % për një sëmundje të caktuar.

**Fadil Beka** mendon që amendamentin si e kemi bërë ne ka qenë në rregull, vetëm mund ta cekim që kjo duhet të rregullohet me ligj të veçantë.

**Adem Hoxha** tha se këta persona me 100 % paaftësi mund të jenë me përgatitje të ndryshme profesionale dhe duhet të kenë asistent me pagesë, dhe nuk duhet të shikohet buxheti.

**Hatim Baxhaku**, tha se ne të gjithë pajtohem që këta persona të kenë asistent dhe asistenti të paguhet, por dilema është se a e rregullon ky ligj apo kjo të rregullohet me ligj të veçantë.

**Flora Brovina:** Edhe unë mendoj që kjo të rregullohet me ligj të veçantë, por derisa të rregullohet me ligj të veçantë të mbetet edhe në këtë Projektligj, të mos fshihet.

Pas diskutimeve Komisioni njëzëri vendosi që amendamenti 5, të riformulohet si vijon:

#### **Amendamenti 5**

Neni 11 i Projektligjit, riformulohet si vijon:

1. Në nenin 18 të ligjit bazik, në fund të paragrafit 1, fjalia „ligjeve tatimore dhe doganore në fuqi” zëvendësohet me „një akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës”.
2. Në nenin 18 të ligjit bazik, në fund të paragrafit 2, shtohet fjalia „ dhe kjo të rregullohet me ligj të veçantë.

#### **4. Të ndryshme.**

Për këtë pikë nuk pati ndonjë çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

**E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetarja e Komisionit,**

---

**Flora BROVINA**